



Sfida e skuadrave kryesuese e luajtur ne Korce ka perfunduar ne barazim. Teuta ka te drejte te ndihet e fituar pasi ka luajtur me 10 lojtare per afro 75 minuta. Skenderbeu i Joses ka bere nje pjese te pare te shemtuar dhe nje super pjese te dyte me raste te shumta te humbura para portes. Golashenuesi i kampionatit Daniel Xhafaj ka shenuar serish dhe kaq i ka mjaftuar durrsakeve per te zhblokuar rezultatin. Feste per tifozet e Teutes dhe heshtje per korcaret e shumte ne stadium. Ne pjesen e dyte, kampionet kane shtuar presionin dhe kane goditur shtyllen me Muzaken, kane shenuar dy here dy gola te cilesuar te parregullt nga anesori dhe ne fund kane barazuar me Mario Morinen. Fati i ka mohuar fitoren Skenderbeut dhe ka ndihmuar Teuten qe me shpirt neper dhembe kane rezistuar deri ne fund dhe kane marre nje pike te cmuar ne transferte.